



# NACIONAL

Revistë periodike, letrare, kulturore, politike

Adresa: Ish-kinostudio "Shqipëria e re", Tiranë  
E-mail: nacionalalbania@yahoo.com, bucpapaj@yahoo.com



## Presidenti Obama: Një fillim i ri me botën myslimane

Presidenti amerikan Barak Obama bëri thirrje për një fillim të ri në marrëdhëniet mes Shteteve të Bashkuara dhe një miliardë myslimanëve të botës, duke thënë se duhet të marrë fund cikli "i dyshimeve dhe përplasjeve".

faqe 3



## Si ruhet qetësia në Ballkan

Intervistë e gazetës "Nacional"  
me liderin e  
"Vetëvendosjes", ALBIL KURTI

faqe 5

## Zgjedhjet në Shqipëri

Nga MUJË BUÇPAPAJ

Zgjedhjet e shtata kombëtare në historinë e pluralizmit politik të Shqipërisë po eksperimentojnë një sistem të ri zgjedhor, duke provuar njëkohësisht edhe mbesh-tetjen popullore për dy partitë kryesore politike në vend dhe aleatët e tyre.

faqe 2

## Pavarësia e Kosovës është e pakthyeshme

Nga Gani MEHMETAJ

Vizita njëditore e Xhozef Bajdenit në Kosovë ishte ngjarja më e madhe e vitit 2009.

faqe 2

## Lugina e Preshevës po vritet në heshtje

Nga SHKURTE VELIU

E vetme- pa emër, e varfër pa zemër, në fytyrë e trishtë, pa liri, e gjymtë-është kjo lugina e Preshevës...

faqe 4

## Shpirtvegjëliti janë denigrues

Nga Nazmi LUKAJ

Njerëzit e mëdhenj të kombit e të penës janë bërë të tillë, jo pse Zoti i ka krijuar të mëdhenj, por ata të tillë janë bërë me punën e tyre.

faqe 4

## Lufta e UÇK-së dhe e ardhmja në liri

Nga NAIM KELMENDI

Mëtimi për ta demonizuar luftën e UÇK-së të vitit 1998-99, kuptohet nga ana e Serbisë dhe nga satelitët e saj, nuk ka pushuar që nga përfundimi i luftës e këndeje.

faqe 3

## Kontributi i Bujanit në histori

Nga HASAN MEHMETI

Bujani dhe gjithë Krasniqja e ka prejardhjen nga Lipjani i sotshëm.

faqe 15

Ja si perendori Galigula e bëri kalin e tij Incitatus senator

# Edhe kalin senator

faqe 20



Intervista me këngëtarët e mirënjohur shqiptarë

Arben Sinoni: "Jam Tirons i vjeter"

Arben Gjeloshi: "Nuk jam zhgenjyer"

Manjola Mace: "Kam kënduar qysh e vogël"

faqe 23

## Gjithçka rreth jetës së ERNEST HEMINGUEJ



faqe 19

## MITINGU I POEZISË NË GJAKOVË



faqe 14

## Në BRENDËSI

DIMENSIONI I KATËRT  
NË FILMAT E  
MIJAZAKIT

Studim nga Gjekë Marinaj

faqe

12-13

GOOD MORNING,  
AMERICA

Poemë nga  
CARL SANDBURG

faqe

6-7

ERNESTO

Tregim nga  
Fasli Haliti

faqe

8

POETË ZVICERANE

faqe

10-11

POEZI PËR MARTËN

Nga EDWARD H. GARCIA

faqe

7

"GRABJANI RRËZË  
KODRAVE"

Kritikë nga  
Perikli Jorgoni

faqe

17

Tregime nga  
Fatmir Terziu  
dhe Aleko Likaj

faqe

8-18

NJË DITË NË VALBONË

Reportazh nga Gjon NEÇAJ

faqe

9





Po, ka pasur një ndërkohë,  
Kur fantazmat lanin këmishët e tyre të bardha  
Përsëri e përsëri në kovat e gjakut-  
Dhe fantazma më e pikëlluar prej të gjithave qëndronte në këmbë në Gettysburg 6)  
Duke u përpjekur që të ndante atë që duhej bërë nga ajo që s' duhej duke e lënë  
të shumtën të pathënë, nëpër ajër.

6) Beteja e Gettysburg-ut, një nga më të shënuarat gjatë Luftës Civile,  
e cila u zhvillua më 1-3 Korrikun e vitit 1863. Më 19 Nëntorin e 1863,  
kjo fushë-beteje u nderua prej Presidentit Linkoln si varrezë nacionale.  
Atë ditë Linkoln në Gettysburg mbajti një fjalim të shkurtër disa minuta,  
që mbeti i përjetësuar.

14

Tani është Xhaxha Sami 7) duke u ulur në kulmin e rruzullit.  
Jo shumë kohë më parë në kulmin e botës ishte Xhon Bull 8) dhe, pak më herët, ishte  
Napoleoni dhe shqiponjat e Francës që i tregonin botës nga të nisej.  
Spanja, Roma, Greqia, Persia, me topat e tyre, heshtat,  
katapultat, anijet, e kanë pasur rradhën e tyre për të  
udhëhequr qytetërimet e kësaj toke -  
Një nga një ata e kanë hequr qafe njëri-tjetrin, ia kanë zënë vendin njëri-tjetrit, e kanë  
mashtuar dhe lënë prapa njëri-tjetrin; ata vdiqën, humbën ose mbetën si relike, kjo s' është fort  
mirë, s' është fort mirë.  
Njëri pas tjetrit, ata nuk janë më në kulmin e rruzullit – tani i Ardhuri  
i Ri është Xhaxha Sami, është Amerika, andaj kënga thotë, “Yjet dhe  
vijat përgjithmonë!”, edhe sikur kjo “përgjithmonë” do të jetë një  
kohë e gjatë...

7) Uncle Sam, Xhaxha Sami, simbolizon SHBA  
8) John Bull, simbolizon Britaninë e Madhe, sepse është krijuesi i Hymnit Kombëtar

15

Tek Zoti ne besojmë; kështu është shkruar.  
“Tek Zoti ne besojmë” është shkruar edhe në çdo dollar të argjenditë.  
Fakt: është se Zoti i Gjithfuqishëm na ka krijuar që të gjithëve.  
Ne është ju dhe unë dhe të gjithë ne jemi Shtetet e Bashkuara të Amerikës.  
Dhe të besosh Zotin do të thotë se ne i flijohemi,  
të gjithë ne, Shtetet e Bashkuara të Amerikës,  
Zotit, të Madhit Zot.  
Po...ndoshta... a është kështu ?  
.....

18


Dhe ne, ne populli,  
Ne të cilët, natyrisht, nuk jemi somnambul, jerm  
Ndoshta ne mund të murmurisim –  
Ndoshta ndërsa pilotët shkasin në palltot e tyre të lëkurta,  
Duke rrezikuar, me kohën që skadon përpara, dhe që i ngjan kafkës  
të kryqëzuar me kocka, që do të thotë rrezik-vdekje,  
Duke kalëruar me thasët e postës mbi shpinë përmes portokalleve gjatë lulëzimit,  
shkretëtirave të kaktusit, Maleve Shkëmbore, Rrafshinave të Mëdhaja, Lumit Misisipi, atje ku  
mbillet dhe korret misri, Maleve Apalache,  
Kalëruar me thasët e postës mbi shpinë, duke mbërthyer me mish e shpirt timonin  
nëpër sulmet me luftëthirrjen kalimtare, “Fat të Bardhë dhe Zoti ju bekoftë,”  
Ndoshta, ndërsa ata kalërojnë dhe rrezikojnë nëpër rrugëtimin drejt qiellit përtejkontinental,  
ndoshta ne mund të përshëndesim duke murmuritur –  
Mirëmëngjez, Amerikë,  
Mirëmëngjez, Zotëria Kush, Cili, Çfarë,  
Mirëmëngjez, le të themi që të gjithë ne,  
emrat tanë të vërtetë.  
Mirëmëngjez Zotëri Dikushi, Askushi,  
Kurrëkushi-që është Kurrëkushi krejt.  
Mirëmëngjez, ju Larvat në Pluhur, Shqiponjat  
në fluturim, dhe ju Pushtuesit e Kulmit të  
Qiellit.

19

Ju i keni dhënë puthjen e lamtumirës një shekulli, një albumi të vogël të paçmueshëm.  
Ju keni për t' i dhënë puthjen e lamtumirës dhjetë, njëzetë shekujve që do të vijnë. Ah ! ju  
keni për të pasur kaq shumë albume !  
Nëna juaj, Amerika ka punuar dhe ka mbledhur të korrat, frytet e gjeneratave –  
Përtej kaskadës, vijnë të korrat e reja, gjenerata të reja të zhurmëshme,  
të ardhur të rinj, që thërrasin, “Ja ku na keni ! Ne i përkasim Amerikës !  
Shikona ne !”  
MIRËMËNGJEZ, AMERIKË !  
.....

E shqipëroi: Elida BUÇPAPAJ

# Tamam ai që isha



Nga EDWARD H. GARCIA

## MEKSIKANIZMI NË MUA

Një vajzë e re me flokë të kuq  
Në klasën e gjashtë  
Një vallëzim në Klubin Krahinor.  
Unë, veç adoleshent  
Një njomak, nerv i ekspozuar.

Vajza flokëkuqe me emër Cindy  
U shfaq: “Më vjen mirë që nuk jam ti.  
Ato gratë po flasin rreth teje.”  
Për mua fjalët patën shijen e vdekjes.

Atë moment qeshë i bindur  
Se më kishin zbuluar të tërin  
E kishin nuhatur sekretin e dyshimit tim  
E kishin nuhatur meksikanizmin në mua.  
Shpirti im u turbullua nga turpi.

Cindy, mirësia e saj e kryer,  
Shkojë me dikë tjetër,  
Duke më lënë të struktur,  
Të qullësuar në turpin se qeshë  
Tamam ai që isha.

## PRAPË DJEMTË TUAJ

Dy djem të zeshkët që kurrë nuk marrin rrugën e  
lehtë  
Njëri që duket se gjen krenari  
Tek godet çdo të padrejtë  
Tjetri që pretendon  
Se nuk ekzistojnë.  
Njëri gjithmonë në ikje  
Tjetri afërt por i lëvizshëm

Njëri që të bëri ty nënë  
Ai që i pëlqente të ledhatohej  
Tjetri havale gjithmonë në ikje, tani i larguar  
Ai që e dinte se është fëmija yt i çmuar  
Mbetet i çmuar.

Dy djem zeshkanë të ngatërruar në zemrën tënde  
Të lëshuar të lirë, me dashuri,  
Por ju nuk jeni kurrë e lirë.  
Shpejt dy burra zeshkanë:  
Prapë djemtë e tu.

Edward H. Garcia u lind në Brownsville, TX, në vitin 1942. Prej më se 42 vjetësh punon si profesor i letërsisë. Poezitë e tij janë publikuar nga një numër i madh revistash dhe antologjish amerikane si në: Texas Observer, Voices from Within, Van Zandt County Lines, Dallas Morning News, Pawn Review, Texas in Poetry 2, Texas Books in Review, Phi Delta Kappan, Texas Humanist, Out of Dallas, Tex!, and Texas Short Stories 2 etj., etij. Garcia është i njohur në letërsinë amerikane si një poet që lufton për një poezi të kuptueshme që ka lidhje me lexuesin dhe që pasqyron realitetin sa më pastër.

## POEZI PËR MARTËN

“Kam insekte në kokë”  
Mendime të ngrohta rrëshqasin poshtë  
Kërcënime të padukshme  
Në vetëdije  
Bymehen, zgjatën me kuriozitet përpara  
Rrugë-humbura, si duket, të pafuara.

Miza mendimesh  
Vetëm të mërzitshme  
Tepër të parëndësishme për t' i parë  
Megjithatë i ndjek.

Milingona mendimesh  
Mashtruese dhe helmuese  
Tmerrsisht të rrezikshme.

Mollëkuqe mendimesh  
Rrumbullake dhe të vetëkënaqura.

Shushunja mendimesh  
Të ngadalta dhe amorf  
Por të hijshme, të hijshme.

Duke qëndruar heshtur këtu  
Në këtë metër katrore të tokës,  
Mësoj se kam insekte  
Në kokë.

## TRUMCAKU

Së pari dëgjova këngën,  
Zërin e plotë të trumcakut  
Ciu, ciciu, ciciu, ciu.  
Vallë, po na tregon folenë,  
Apo po na mbanë larg prej saj?  
Fole e pasur në një gyp shporetit  
Të hedhur diku pas shtëpisë.  
Pastaj e pashë.  
Çuditërisht i vogël.  
Me fyt të tharë  
pezull mbi një degëz të thyer  
Si pika mbi “i”-në  
Fyti i tij pulsonte  
Si një zemër  
Nën gjoksin me pupla  
Që dridhej: Ciu, ciciu, ciciu, ciu.  
Më me zë se madhësia e tij.

Ai ndoshta këndon për atë  
Bukuroshen në kafaz,  
Që flakëron vetëm  
Të ndizen bashkë në freskun e saj.

Ah sikur të ishit aty  
Të ishit aty  
Gjëja më e vërtetë që mund t' ju them  
Edhe unë do të ndizesh me ta,  
Për të gjithë ju.

Përktheu Gjekë Marinaj

# FRIKA SI DIMENSION I KATËRT NË FILMAT VIZATIMORË TË MIJAZAKIT



Në foto Gjekë Marinaj

Mirënjohja e pakrahasueshme që gëzon Haijao Mijazaki si regjisor i shumë filmave vizatimorë me metrazh të gjatë si: “Shërbi mi Shpërndarës i Kikisë” (*Kiki's Delivery Service*), “Komshiu im Totoro” (*My Neighbor Totoro*), “Princesha Mononoke” (*Princess Mononoke*), “Nausika e Luginës së Erës” (*Nausicaä of the Valley of the Wind*) dhe filmi fitues i “Academy Award” “Zanë-Shitaur” (*Spirited Away*), është plotësisht e merituar. Ia vlen të përmendim se edhe pse i ka përshtatur me sukses disa romane fantastike në filmat vizatimorë si romani i Diana Wynne Jones, “Kështjella në Lëvizje e Houliit”, pjesa më e madhe e filmave që drejton bazohen në librat e tij komik. Kjo ende luan një rol të madh në rritjen e reputacionit të tij, sepse deri në një farë mase “në Japoni, fjala për filmat vizatimorë (anime) lidhet ngushtë me librat (manga)—një formë e librave komike që e kanë zanafillën artistike në trajtën e tregimeve të ilustruara në vijimësi: si librat me rrëfime të cilat lexohen nga të gjithë, me përmbajtje të gjerë dhe shpesh herë të rëndësishme” (Moist & Bartholow 28). Kjo përbën universin e Mijazakit, i cili mund të shkruajë libra të shkëlqyer humoristikë, të përshtatë romanet fantastike dhe skicat komike në filmat vizatimorë dhe të jetë regjisor i tyre, i cili përmes mjeteve artistike kërkon ta çojë njerëzimin drejt paqes së vërtetë, drejt paqes së qëndrueshme.

Këto tre elemente të veprave të tij duhet të mjaftojnë të sjellin forcën e duhur artistike dhe cilësore për ta portretizuar artistin japonez si “ikona e kulturës Japoneze, i cili konsiderohet si nga teknikët e filmave vizatimorë japonezë, ashtu edhe ata amerikanë si një “perëndi” (Hairston). Megjithatë as talenti, as teknika apo qëndrimi pozitiv nuk përbëjnë medoemos të ashtuquajturën “vepër gjeniale.” Sipas asaj që besoj, është shumë e rëndësishme që çdo vepër arti të ketë një element të katërt, një forcë të brendshme energjike, një “Nausika” apo një “Kiki” në mënyrë që të jetë e gjallë dhe të komunikojë lirshëm me artdashësit. Ndaj në këtë ese do të argumentojmë se ky lloj burim force që është i gjithë pranishëm në filmat vizatimorë të Mijazakit, përbëhet pikërisht nga koncepti i frikës. Në paragrafët e mëposhtëm, veç kësaj do të analizojmë, vlerësojmë dhe përqendrohemi në faktin se si Mijazaki e përdor konceptin e frikës (në çdo sinonim të fjalës), në rastet kur person-

azheve të tij u cenohet sinqeriteti, kur tjetrit i gjenden në rrezik të lartë sendet e një rëndësie të jashtëzakonshme, si dhe kur përfshirja e njeriut në një luftë me shumë fronte është e pae-vitueshme.

Koncepti i sinqeritetit (ndershmërisë) përbën një nga temat e njohura të Mijazakit. Personazhet e tij nuk duan të shihen si gënjeshtarë, pavarësisht moshës apo pozitës në shoqëritë përkatëse. Ndjesia e frikës dhe shqetësimit i kapërcejnë kufijtë e asaj frike që të bën të ndjehesh i marrë apo rrenacak e që mbarset në mendimet dhe emocionet e personazheve të Mijazakit si p.sh: Mei tek “Komshiu im Totoro”, Kapiten Jupa tek “Nausika e Luginës së Erës” dhe babai i Pazusë tek “Kështjella në qiell”. Strategjia e Mijazakit është e thjeshtë, por e suksesshme. Ndryshe nga filmat vizatimorë të Dizneit, ai nuk krijon personazhe që për çfarëdo lloj qëllimi zgjedhin të thonë gënjeshtër dhe më vonë përballesh me pasojat e tyre. Përkundrazi, Mijazaki krijon një forcë të natyrshme, ku frika e të qenit gënjeshtar është shumë herë më e pallogaritshme se sa ndëshkimi i merituar për gënjeshtër. Kalimi drejt kësaj teme funksionon më së miri, pasi filmat vizatimorë ashtu si edhe “shkrimet fantastike duhet të mbështeten tek e vërteta dhe përvoja e jetuar, nëse duam të arrijmë suksesin. Tema mund të jetë sa krijuese, aq edhe origjinale, ashtu siç e përcjell autori, me një lumë metaforash dhe gërshtime të subjektivit, por gjithsesi nuk mund të krijohet në ajër. Bota duhet të identifikohet me botën tonë, duhet të na sjellë një pikë referimi për ta dalluar” (Terry Brooks). Mijazaki me sa duket është i ndërgjegjësuar më së miri se, as frika e të quajturit gënjeshtar nuk mbështet në kotësi. Mbi të gjitha ai e di me saktësi se sa dhe çfarë lloj frike mund të zënë emocionet e personazheve. Ndaj le të përcaktojmë skenarët në lidhje me vendndodhjen e tyre.

Fill pasi gruaja i shtrohet në spital, babai i Meit vendos t’i çojë dy vajzat në shtëpinë e vjetër që ndodhet diku në fshat për t’iu arratisur monotonisë së jetës. Mei e cila është katër vjeç, nisat drejt pyllit, pa lejen e babait dhe të motrës Satsuki 10- vjeçare dhe atje takon Totoron. Pasi e gjetën ku ndodhej, Mei këmbëngul se Totoroja ishte i vërtetë, ndërsa motra dhe babai i saj qeshnin me të. Ajo trishtohet sepse ka frikë nga dyshimi i tyre: “Mjaft qeshët! Është e vërtetë, nuk ju gënjej. Nuk më besoni!” (Komshiu im Totoro me dvd). Ideja që shtjellon Mijazaki është se dyshimi i parakohshëm mund të sjellë pasoja tronditëse, e cila përbën vetëm njëherë anë të mesazhit. Pjesa tjetër transmetohet përmes veprave të Totoros dhe jo përmes fjalëve të tij.

“Magjia ose ndryshe forca e fantazisë njerëzore mund të ekzistojë në botë në lidhje me misteret e natyrës e cila është njëra pjesë e mesazhit të Totoros. Por ndoshta pjesa më e rëndësishme e mesazhit është se për t’u lidhur me fuqinë njerëzore nevojitet, jo vetëm guxim, durim dhe imagjinatë, por edhe gatishmëri për të pranuar vështirësitë, dobësitë që ndoshta simbolizohen më së miri me figurën e vajzës së vogël” (Napier 160).

Sipas versionit të librit “Nausika e Luginës së Erës,” komandant Jupa e gjen veten në të njëjtat rrethana sikurse Mei. Megjithatë kushtet janë shumë më të vështira, ai shpreh frikën e

madhe kur përballet me shqetësimin për portretizimin e tij si gënjeshtar. Ai është një burrë i mençur, luftëtar dhe këshilltar për Nausikan. Sidoqoftë i duhet të dhurojë krahun e prerë për të vërtetuar sinqeritetin e tij: “E dhuroj këtë krah si provë e sinqeritetit tim. Kuptomë, të lutem” (Mijazaki 74). Por “kështu është vlera e letërsisë artistike, nisim ta dyshojmë, që jo vetëm na tërheq, apo na largon prej shqetësimeve, por na ndihmon të kuptojmë atë që besojmë, na risjell cilësitë më fisnike dhe na bën të kemi ankth për fajet dhe kufizimet tona” (Gardner 31). Kështu Mijazaki duke mos pasur faje apo kufizime i fton lexuesit të dëshmojnë rreth skenave tragjike, ku sinqeriteti i Komandant Jupës humbet vlerat reale, jo sepse nuk janë më të rëndësishme për kushtet në të cilat ndodhet, por sepse disa njerëz në rrethana të caktuara nuk janë në gjendje të merren me to.

Tek filmi “Kështjella në qiell” regjisorit shkon pak më tutje duke e zmadhuar metaforën e frikës, që njihet me emrin gënjeshtar (i madh) drejt ndryshimit. Kjo ndodh kur Sheeta dhe Pazu po shohin një fotografi të Laputës të shkrepur nga babai i Pazusë. Pazu i tregon Sheetas se babai i tij, pilot dhe eksplorator, “e dinte me siguri se kështjella kishte thesare, por asnjë nuk i besonte. Ata e quajtën gënjeshtar. Arsyeja që e vrau atë ishte se e quajtën gënjeshtar.” Sipas këtij shembulli, Mijazaki pasqyron ngjarjet më të papëlqyeshme, ku në veçanti përmbajtja e fjalës “gënjeshtar” nuk është e ngjashme me kuptimin me të cilën qarkullon. Ai nuk përbën thjesht konceptin teorik të fjalëve dhe aq më tepër atë metaforik, por paraqet thjesht vrasësin gjakftohtë. Ai premtan se sipas asaj që kupton, fjalët për frikën e Komandant Jupës shihen si të mbartnin “kuptimin e duhur” përmes të cilave mund të shprehesh të vërtetat. Në këto kushte për t’i përdorur fjalët në mënyrë metaforike do të thotë të përdoren me kuptimin e papërshtatshëm, për të pjellë imagjinatën dhe më vonë emocionet e si rrjedhim për të na larguar nga e vërteta drejt fantazisë. (Lakoff & Johnson 191). Prandaj Mijazaki është përfaqësues “i hiperbolizimit” jo vetëm si fenomen fantastik për shikuesin, por më tepër si balanca simbolike midis dy ekstremeve: qytetit fluturues dhe vdekjes së dëshmitarit të vetëm të këtij qyteti, të cilat Mijazaki i bashkon mjeshtërisht. Ai vepron pjesërisht, duke i vendosur personazhet Sheeta dhe Pazu drejt fitores me Muskën dhe planeve të tij për të shfrytëzuar pasuritë e Laputës për fitime personale.

Sheeta më çon drejt një hapi tjetër gjykim, i cili do të thotë se Mijazaki po përgatit personazhet e tij të jenë në gjendje të mbrojnë pasuritë e tyre të çmuara. Në këto rrethana ai përhap konceptin e frikës, e frikës nga humbja e asaj që është me më shumë vlerë. Duke iu drejtuar kësaj teme, Mijazaki e paraqet frikën përmes një game të gjerë që lind në harmoni me vlerësimin e çdo pasurie në veçanti. Për shembull, Sheeta trashëgoi një gur të çmuar që jo vetëm mbarte në vetvete forcën për të qëndruar në qiell deri sa të pushonte pak nga pak në krahët e Pazusë, por që përmes një tufe drite e nxirrte Sheetanë nga rreziku ose e çonte drejt synimit të rëndësishëm, drejt mbretërisë së qiellit të Laputës. Kjo në të vërtetë ndodhi në filmin “Kështjella në Qiell” e frymëzuar nga “Udhëtimet e Guliverit” të Xhonatan Suifit. Për shkak

“Kjo përbën universin e Mijazakit, i cili mund të shkruajë libra të shkëlqyer humoristikë, të përshtatë romanet fantastike dhe skicat komike në filmat vizatimorë dhe të jetë regjisor i tyre, i cili përmes mjeteve artistike kërkon ta çojë njerëzimin drejt paqes së vërtetë, drejt paqes së qëndrueshme”

se, “frika e metaforës dhe retorikës sipas traditës empirike përbëjnë frikën e subjektivizmit, frikën ndaj emocioneve dhe fantazisë” (Lakoff & Johnson 191), Mijazaki kryeson me forcën e shkrimeve trilluese për të nxjerrë atë pikë të fortë që vërteton se konfliktet shpesh herë lindin si pasojë ose e botës materiale, ose e botës shpirtërore.

Lufta e Sheetas për të mbrojtur gurin e çmuar jepet më tepër instiktive se sa e paramenduar. Fillimisht ajo nuk kishte dijeni se ku do të përfundonte guri, aq sa shpëton prej avionit që kishte hipur dhe u arratiset piratëve të qiellit të cilët vunë re se ajo rrëmbeu varësen me gur të çmuar nga Muska. Por ajo dinte vetëm se guri përmbante diçka të misterishme: “As që e kisha pasur idenë se guri im i çmuar ishte kaq i fuqishëm. Për një kohë të gjatë e kisha pasur në shtëpinë time. Nëna ma kishte dhuruar, para se të vdiste dhe më kishte thënë të mos ia jepja kujt, qoftë edhe për ta parë” (Kështjella në Qiell me dvd). Çapënia e kuptoi vlerën reale të gurit, kur Pazuja i kujton se “Dola dhe burri me syze” e kërkojnë atë varëse. Por vetëm xhaxha Pomi u thotë se guri i saj është puro kristal prej atriumi një nga gurët e pastër dhe të kulluar. Ai informon si Sheetan, ashtu edhe Pazunë se, guri i çmuar e bën Laputën të fluturojë në qiell dhe se kjo “legjendë bën që vetëm njerëzit e qytetit fluturues të Laputës të dinë se si të nxjerrin gurë të tillë” (Kështjella në Qiell me dvd). Në atë çast Sheeta arriti sinkronizimin e saj me Kështjellën Laputa. Mijazaki i vesh Sheetas identitetin e saj dhe nuk e paraqet sipas modelit të Guliverit i cili “kësaj radhe i ka përjetimet më të larmishme. Ai viziton ishullin fluturues të Laputës, shtëpinë e “elitës në pushtet” e cila është e çoroditur se është përpër nga muzika, matematika dhe mendimet filozofike” (Cunliffe {Suiff} xv). Ky është hapi i duhur sepse Mijazakit i duhet të ngrejë nivelin e frikës deri në atë farë mase, sa të nxjerrë pjesën tjetër të personit, provat për kuriozitetin e gjithsecilit pas këtij guri dhe për më tepër përpiqet ta ngjiz atë lloj frike.

Frika e Kihiros tek filmi “Zanë-Shitaur” del më e hiperbolizuar nga Mijazaki. Në skenën e parë të filmit, ajo është thjesht një vajzë e vogël, shqetësimi më i madh i së cilës është lufta e ashpër e babait të saj me mënyrat e reja të mbretërimit. Fati i vajzës ndryshon nga Mijazaki sa hap e mbyll sytë. Fillimisht i frikësohet humbjes së nënës neglizhuese dhe babait egoist që për shkak të një magjie mbinatyrore u shndërruan në derra. Ndërsa ajo përpiqet të





përshatet me mjedisin gjithnjë e në ndryshim, i ravijëzohet edhe më shumë karakteri. Pas pak një i ri i quajtur Haku i thotë se për të thyer magjinë e cila do t'i kthente prindërit përsëri në njerëz, do t'i duhej të punonte në azil. Meqë ishte protagonistja e Mijazakit, do t'i duhej të mbante nën kontroll çdo betejë të jashtëzakonshme që mund t'i dilte përpara. Në të vërtetë ato nuk ishin të lehta. Përpara saj del në pah frika tjetër se mos humbte diçka edhe më të rëndësishme:

“Kur Kihiro nis punën, i heqin emrin dhe nga ‘Kihiro’ Jubabaja e thërret ‘Sen’. Seni është një tjetër shqiptim për shkronjën kineze ‘chi’ e cila formon trokjen e parë të emrit të saj të vërtetë ‘Kihiro’ që do të thotë ‘një mijë’ apo ‘numër i madh’. Siç e shpjegon Hakua, Jubabaja mban nën kontroll punëtorët duke jua hequr emrat. Meqë quhej Sen do të thoshte identiteti i humbur apo i hequr dhe ajo pothuajse e harron emrin e saj kur po bisedonte një ditë që herët në mëngjes me Hakuan në kopshtin me lule dhe u ulërinte prindërve në stallën e derrave, ‘Jam Seni!’” (Reider 5).

Pse e vendos Mijazaki vajzën e vogël në vuajtje fizike dhe shpirtërore kaq të mëdha? Cila do të ketë qenë arsyeja, strategjia e Mijazakit për të luftuar frikën e saj ekzistuese për humbjen e prindërve me një tjetër lloj frike që ka të bëjë me humbjen e emrit do të ishte më ndikues, se sa të luftoje frikën e parë vetëm me kurajën. Kjo sigurisht do të thotë se nëse Mijazaki nuk ndjen keqardhje për personazhin e tij, siç bënte pa dyshim dikur për Kushanën, një nga personazhet kryesore tek filmi “Nausika e Luginës së Erës”: “Kur shkruaja për Kushanën, vazhdoja të ndieja keqardhje për të. Personazhi i saj nuk kishte lidhje me librin. Ndaj isha në mëdyshje. Mendova se më duhej të prekja lidhjen e saj me të ëmën dhe këtë duhej ta përshkruaja më hapazazi, por për këtë kisha vetëm një faqe” (Intervista e Saitanit). Nëse kjo ishte çështja, atëherë do të ishte e udhës të mendoje se duhej t'i hynte një bote që i jep mundësi të harronte realitetet e frikshme të së tashmes dhe të tentonte të bashkonte të shkuarën me të ardhmen e saj. Ky do të ishte pjesërisht një hap i mençur sepse sipas traditës japoneze të filmave vizatimorë, “në çaste të tilla sundon kriza, ankthi e pesimizmi dhe njerëzit nuk shohin nga e ardhmja, por nga e shkuara, duke kërkuar të arratisen” (Satoshi 23). Megjithatë, fakti që filmi “Zanë-Shitaur” (transmetuar në Japoni në vitin 2001), arriti shikueshmërinë e rreth 23 milionë njerëzve dhe voli një fitim prej më se 250 milionë dollarë, na shtyn të mendojmë se njerëzit nuk do e donin, as karakterin e Kihiros, as film të krijuar ndryshe nga ç’është krijuar.

Frika ndaj luftës është një nga temat e përsëritura në librat dhe filmat vizatimorë të Mijazakit. Lufta në vetvete, paraqitet të jetë një nga armiqtë më të urryer të Mijazakit, por kurrsesi nuk ka për mision nxitjen e urrejtjes midis forcave ushtarake që luftojnë kundër njëri-tjetrit. Pjesa më e madhe e veprave të tij, si p.sh. “Nausika e Luginës së Erës” dhe “Princesha Mononoke” demonstrojnë hapazazi reagimet e fuqishme kundër luftës. Pavarësisht nga e gjitha kjo, “çdo fabule të përafërt trilluese i duhet të krijojë një botë të çuditshme dhe t’ia paraqesë lexuesit - por imagjinata e pasur duhet njëkohësisht të vendosë një strukturë të re dhe të plotë të ligjeve të zakonshme, të cilat shtjellohen drejt dhe më vonë i jetojnë me besnikëri kudo gjetkë” (Card 23). Mijazaki duhet të njohë luftën dhe pasojat e pas luftës në vend dhe mes njerëzve e sigurisht në lidhje me ligjet e zakonshme. Haijao Mijazaki u lind me 5 janar 1941 në Tokio, Japoni, që do të thotë se kishte moshën të kuptonte se bombat atomike që u hodhën nga qielli i Hiroshimës dhe Nagasakit ishin sulme bërthamore dhe jo karamelë. Ai besoj se është i mendimit se lufta në Vietnam dhe Irak qenë pa



kuptim. Për këtë u hedh fajin në veçanti udhëheqësve, dhe jo popujve, që e ka kthyer metaforën e luftës në shkatërrimtare e vërtetë për pjesën më të madhe të njerëzimit. Gjatë një interviste me Rio Saitanin, parashtrihen një nga këto arsye:

“Sipas përshkrimit tim për Miralupen, mora parasysh Stalinin, Papën e Katolikëve dhe shumë të tjerë. Një personalitet si ai nuk mund të ndryshohet. Ai është një personalitet i cili gjithmonë bën atë që thotë se do të bëj dhe merr përsipër përgjegjësi të mëdha, pra është në një farë mënyre i tmerrshëm. Ai gjithashtu përpigjet me çdo kusht të ekuilibrojë frikën që kanë njerëzit në shoqëri me murgjit, si edhe shqetësimin që kanë për paqen e vendit. Nëse populli nuk mbahet me frikë, atëherë nuk do të jetë i qytetëruar, e cila sipas tij, mbetet një nga arsyet dinjitoze. Kjo kryesisht është pika e fortë e atij që është në pushtet. Nëse do të shihnit vetë tek individit, do të ndienit keqardhje për të. Por në kohën që ndërmerr veprime, pasojat bëhen të rrezikshme dhe mizore. Ndërsa pa dyshim, ai i shkatërroi pasojat ngaqë nuk kishte besim në vlerat e tij” (Intervista e Saitanit).

Në filmin “Nausika e Luginës së Erës” priemi nga kjo lloj filozofie dhe nuk tregojmë dot me gisht se kush janë njerëzit e mirë apo të këqij. Ai përshkruan konflikte, luftëra të jashtëzakonshme të njeriut kundër njeriut dhe njeriut kundër natyrës me kuptime të veçanta për mjedisin. 1000 vite nga Lufta e Detit të Korrupsionit dhe Lugina e Erës ka mbetur akoma e helmuar. Nausika është një nga personazhet e krijuara mjeshtrërisht, një protagoniste e vërtetë, jo vetëm tek versioni i filmit, por edhe seria e librave “Nausika e Luginës së Erës”. Mijazaki e portretizon atë si një bukuri të rrallë e cila dëshiron paqen dhe është oratore e madhe, jo vetëm me njerëzit, por edhe me krijesat e tjera. Ajo është një udhëheqëse e madhe që kërkon të gjejë palët kundërshtarë të ndjekin rrugë të ndryshme, në vend që të kenë një grup të veçantë që të mbajë nën kontroll tjetrin.

Mijazaki të personazhi i Nausikas revokon idenë se ai që frikësohet më shumë nganjëherë është sulmuesi dhe jo mbrojtësi. Ai na paraqet idenë se në dy rrethana të kundërta, përdorimi i të njëjtës gjuhë mbart ndryshime të vogla përmes ngjyrimeve të saj. Në të parën paraqitet Nausika e cila njihet me kafshën e saj shoqëruese, ketër-dhëlpërën e quajtur Teto. Kur ia sollli nga pylli Komandant Jupa, ketri ishte shumë i egër. Nausika përpigjet të përdorë gjuhë të ëmbël për ta zbutur atë: “Mos ki frikë, s’ke pse të kesh frikë, nuk ka gjë, nuk ka pse frikësohesh, kupton s’ka gjë për t’u frikësuar. Ti vetëm se pate pak frikë, apo jo!” (Nausika e Luginës së Erës me dvd). Në rrethana të tjera kur Kushana paraqitet komandante e Ushtirisë së Tolmekianit i bërret Nausikas: “Mos lëviz! Jam unë ajo që jap urdhra!” (Nausika e Luginës së Erës me dvd). Ajo përgjigjet: “Pse ke kaq shumë

frikë? Reagon sikur të ishte ketër - dhëlpër. Mos ki frikë, nuk ka pse të kesh frikë. Dua vetëm që të kthehesh në vendin tënd” (Nausika nga Luginës e Erës me dvd). Mijazaki e pajis Nausikanë me cilësitë e të plotfuqishmes, që janë vendime tipike për regjisorin Mijazaki. Ajo është vajzë vizionare, e cila kërkon të shkojë përtej traditave të mijëvjeçarit të luftës dhe urrejtjes. Ajo kërkon një jetë me paqe për gjithë njerëzit, në një mjedis të pastër nga ndotjet. Megjithatë ajo lufton dhe vret njerëz. Në këtë aspekt, ajo nuk ndryshon nga Kushana. Mijazaki ecën më tej me intervistën e tij me Saitanin duke thënë se “Nausika dhe Kushana janë tepër të ngjashme, ato janë dy anët e së njëjtës monedhë. Por Kushana për të cilën nxora pak tipare, mbart disa plagë fizike e shpirtërore. Për këtë mendoj se ajo kishte aftësinë për t’u kthyer në sundimtare më të drejtë. Por nuk e dija nëse një komandante e aftë e vijës së parë ishte në gjendje të ishte sundimtare e zonja, ndaj nuk e bëra të tillë” (Intervista e Saitanit). Vetëm se Nausika shfaq gjasa të pendesës për veprimet e saj në një nga bisedat me këshilltarin lordin Jupa: “Lordi Jupa, kam frikë për veten time. Nuk e dija se inati do të më çonte drejt vrasjes. Nuk ka më vrasje, duhet ndaluar” (Nausika e Luginës së Erës me dvd). Prandaj ne:

“nuk duhet t’i marrim këto fabula si të jenë bota materiale e sugjeruar për njerëzimin. Sipas termave budiste, mund të themi se përmes imagjinatës, dhuna endet si një metaforë e betejave brenda nesh, sa herë që provojmë t’i shndërojnë tre elementet e lakmës, keqdashjes dhe mashtrimit (që gjenden tek të këqijtë) në tre virtyte të bujarisë, mirësisë dhe urtësisë të mishëruar tek të mirët” (Loy & Goodhew 76).

Veç kësaj Nausika nuk është vetëm në grafikët e frikshëm dhe njerëzit rebelë nëpër filmat vizatimorë të Mijazakit. Ai merr copëza të frikës dhe manipulon përmes personazheve të tij me koncepte të ndjeshme për të cilat mendojmë se kemi dijeni dhe themi se jemi të njohur me to më së miri. Po të marrim filmin “Kështjella në Qiell”, ushtria përshkruhet si një grup njerëzish të cilët përdorin dhunën fizike, jo sepse është e rëndësishme për të arritur qëllimet e tyre, por sepse Mijazaki kërkon t’i paraqesë kështu, të sillen si të ishin të hutuar, të shkuajdesur dhe me sa më shumë respekt të jetë e mundur me kundërshtarin e tyre. Ai e përshkruan frikën si diçka, për të cilën duhet të kemi disa kategori në mendje se si vjen, që mund të jetë në stereotipin e gjinisë, moshës, mund të jetë çdo lloj gjase me mendje apo armë. Mund të jetë një vend apo disa rregulla sociale që na shkakton neve shikuesve apo lexuesve hedhjen poshtë të bindjeve tona. Megjithatë, si zakonisht nuk gjejmë edhe aq shumë bindje për shkrimet me imagjinatë, pasi “imagjinata e përdorur që në llojin e saj, has vështirësi, i tërheq sytë e mendjes deri në pikën ndarëse dhe krijon hiperbola në çdo faqe libri” (Armit 193). Vetëm duke bërë kështu, na bën t’i besojmë atij për atë që kërkon të dimë dhe jo medoemos atë me të cilën jemi mësuar nga gjithë përvojat e rënda me frikën dhe luftën. Kjo përbën një nga teknikat krijuese që ndërveprojnë në shumë prej filmave të tij sepse “si në imagjinatën hyrëse dhe të qëllimit, personazhi largohet prej vendeve të zakonshme dhe kalon nga hyrja drejt një vendi të panjohur” (Mendelson 2).

“Kështjella Lëvizëse e Houlit” është një tjetër film i mirë, jo vetëm për t’i ndihmuar shikuesit të kuptojnë atë ç’ka Mendelsoni nënkuptonte në të vërtetë me “hapat gjatë hyrjes”, por edhe të ndjejnë njëkohësisht se si dallgët e frikës ndikojnë në jetën metaforike të Mijazakit. Me largimin e Princit Justin, lufta kthehet në një fakt të qartë e të pashmangshëm. Të dyja palët kërkojnë ndihmën e Houlit. Ai i frikësohet luftës dhe nuk i beson rekrutëve të saj. Si përfundim nuk pranon t’i bashkëngjitet asaj. Sofi shndërrohet në të vetmen krijesë për të cilën ia vlen të luftosh, (por jo mbretërit). Megjithëse ajo mbart

një mesazh kontradiktore metaforik, në lidhje me frikën e njeriut në filmin “Kështjella Lëvizëse e Houlit”. Në kohën kur shndërrohet nga adoleshente në plakë, Sofi e cila ndihet e dërmuar përpigjet të gjejë diçka të mirë në sjelljen e saj melankolike duke thënë: “Një nga të mirat kur je plak është se asgjë nuk të tremb më” (Kështjella Lëvizëse e Houlit me dvd). Kjo është një nga ato fjali që Mijazaki e kundërshton në episodin mbyllës të filmit: Sofi përfshihet emocionalisht ndërsa pret të rikthehet Houli. Ajo i frikësohet vdekjes dhe është e shqetësuar kur sheh Magjistaren e Plehrave që mbante zemrën e Houlit në duart e saj. Mijazaki sigurohet se shikuesi e kupton çlirimin e madh të saj, në çastin kur zemra e Houlit kthehet dhe punonte më së miri.

Në mbyllje, fama e Haijo Mijazakit, i quajtur “perëndia” i filmave vizatimorë, nuk rrjedh në pika të rëndomta krijuese, por më tepër në cilësinë e veprave të tij, të cilat kanë për qëllim të ndihmojnë paqen e gjithë njerëzimit. Ashitaka, Kihiro, Nausika, Kiki dhe protagonistët e tjerë të filmave vizatimorë dhe librave të tij shndërrohen në personazhe të mrekullueshme, sidomos në lidhje me nxitjen që zbulojnë dhe për një kurajë të lartë e cila nuk do të ishte e nevojshme nëse nuk do të ishte i pranishëm nocioni i frikës. Megjithëse filmat e tij janë shkruar dhe drejtuar me mjeshtrëri, pa injektuar aty metaforën e frikës elementare estetike do të kishin mbetur të mërziatshme dhe do të shfaqeshin zhgënjyese. Por në veprat e Mijazakit nuk gjendet ky lloj zhgënjimi. Ai është një pasuri e madhe për njerëzimin. Nëse gjykimi im do të tingëlonte pak i ekzagjeruar, ai nuk është i tillë. Për këtë, ndoshta nuk do të mund t’u paraqisja lexuesve me prova më bindëse se sa rreshtat vijues. Këto janë shkëputur nga eseja e një historie të vërtetë, të dhimbshme, me titull “Një dhomë e vogël për Enxhin”:

“Kaluan gjatë javë pas operacionit para se procesi i tretjes të kalonte në gjendjen normale. Pas katër javëve të tjera, një nga infermieret më tregoi se do ta shtynin me karrocë në një studio video kasete, që të zgjidhte të shikonte diçka ndryshe nga ato që zakonisht transmetoheshin në televizion. Infermierja paraqiti me kënaqësi dy filma nga videoteka e spitalit të cilët ishin: “Uragan” (Twister) dhe “Burri me të zeza” (Men in Black). Enxhi kaloi vetëm pesë minuta me secilin prej tyre. “Kemi edhe disa filma të tjerë” - thotë infermierja. Por në vend të kësaj, Enxhi iu drejtua Frenkit dhe i tha: “Shko në shtëpi dhe më sill kopjen time të “Kikit”. Atë ditë e pa “Kikin” dy herë dhe më vonë na tha se (përveç vizitave të përjavshme nga i nipi) nuk kishte pasur ngritje morale më të lartë se kjo, për shpirtin e saj, gjatë gjithë kohës që kishte kaluar në spital” (Hairston).

Filmi i Mijazakit “Shërbimi Shpërndarës i Kikisë” nuk mund ta shpëtonte jetën e Enxhit (ajo vdiq nga kanceri) por “Kiki” i dha një ngritje morale që asnjë doktor, infermier apo mjekësi nuk do të mund t’ia jepte. Këtu strategjia profesionale dhe praktike është më se e pranuar nga shikuesit: jo vetëm se frika është një fenomen universal, por edhe për arsyen se shpesh ka gjasa të hiperbolizojnë mishërimin e saj brenda nesh. Ashtu sikurse e përmend edhe Prof. Pamela Gossin ajo është zmadhuere: “po të shëtisni drejt pyllit, sidomos po të ndodheni vetëm dhe dëgjoni një kërcitje, më e zakonshmja është se: nëse kërcitja është e drerit, del që është veçse e lepurit, nëse thua se është e lepurit, del që është e miut, pasi imagjinata i hiperbolizon më shumë gjërat nga sa janë në të vërtetë” (Gossin). Përgjatë këtyre linjave të mendimit, rëndësia e frikës kthehet në një lajtmotiv në botën krijuese të Mijazakit. Në filmat dhe librat e tij, frika shërben si një metaforë e plotfuqishme—jo thjesht si një reagim emocional kundrejt kërcënimeve dhe rreziqeve—por si një metaforë që frymëzon lexuesit dhe shikuesit e tij të mendojnë jashtë komizës së krijimtarisë së tij.

**Përktheu nga anglishtja: Irena Papingji**